REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE VLORË

NOTER ARJANA E. DODI
ADRESA Lagje "Konferenca e Pezës"
Rruga "Jakov Xoxa" nr. 25
TEL: 696800430

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 885** **Nr. koleksioni: 213**

**Fier më 27/07/2020**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2020062760016056830

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**

A2020062760016056830

# KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "FRA&SERE MANIFATTURE" SH.P.K

Sot, më datë 27 korrik 2020 , para meje Notere ARJANA E. DODI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, Lagje "Konferenca e Pezës" Rruga "Jakov Xoxa" nr. 25, u paraqit personalisht:

**PALA SHITËSE:**
**ANTONIO CISTERNINO**, atësia EGIDIO, amësia TERESA, shtetas italian, lindur në NARDO' dhe banues në LECCE, me adresë NARDO' LECCE, lindur më 19/05/1966, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me karten e identitetit italiane me numer AS7321086,
*Këtu e më poshtë për efekt të kësaj kontrate, referuar "Pala shitëse" ose "Shitësi"*

**BLERES:**
**LUCA CORREANI,** atësia MARIO amësia ELDA, shtetas ITALIAN lindur në JESI AN dhe banues në adresën Serra de Conti, Via Fornace 5 - ITALY, lindur më 24/07/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me karten e identitetit italiane me numer AU 1912933.
*Këtu e më poshtë për efekt të kësaj kontrate, referuar "Pala blerëse" ose "Blerësi"*

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "FRA&SERE MANIFATTURE" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**BAZA LIGJORE:**
1-Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
2-Ligji 9901 datë 14-04-2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".
3-Vendim datë 20/07/2020, i Ortakut te vetem të shoqërisë "Fra & Sere Manifatture" shpk.
4-Ligji 110 datë 20/12/2018 "Për Noterinë".

**OBJEKTI I KONTRATËS:**
Shitja e kuotave të kapitalit të shoqërisë "Fra&Sere Manifattuire" shpk në masën 50% nga ana e ortakut Antonio Cisternino dhe blerja e tyre nga blerësi Luca Correani.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS:**

Nga verifikimi i statusit ligjor të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit të Bizneseve, vërtetohet se shoqëria "FRA&SERE MANIFATTURE" shpk, me status aktiv, me qendër në Fier lagje "Bishanake, rruga "Skenderbeu" pallati nr. 2, kt 2, ap. 15, është rregjistruar në rregjistrin tregtar të shoqërive tregtare si

person juridik, me numër NIPT L83130401D, me objekt veprimtarie : "*Prodhim konfeksionesh, punime artizanale, qendisje me makine dhe me dore, hekurosje, paketim. Fason Import-Eksport te artikujve si makina per qepje, makina per qendisje, hekurosje etj. Import- Eksport te perkohshem dhe difinitiv te lendeve te para dhe lendeve ndihmese. Realizim dhe furnizim te sherbimeve teknike ne fushen e prodhimit te veshjeve*", me ortak te vetem ANTONIO CISTERNINO, i cili ka ne pronesi 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Kapitali thelemtar i kësaj shoqërie është 10 000 lekë (dhjetemije) ose një kuotë e vetme.

Ne nenin 73 te ligjit shqiptar nr. 9901 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" qe ben fjale per "*Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave*", percaktohet se "*1- Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:*

*a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;*

*b) shitblerjes;*

*c) trashëgimisë;*

*ç) dhurimit;*

*d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.*

*2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim....*"

Kjo parashikohet edhe ne Statutin e shoqerise, neni 7.

Gjithashtu Ortaku i Vetem Antonio Cisternino, me vendimin date 27/07/2020, ka vendosur miratimin e kalimit te kuotave nepermjet shitblerjes, ne masen 50% nga shitesi Antonio Cisternino, tek bleresi Luca Correani.

Bazuar ne sa me siper, me ane te kesaj kontrate shitblerje, shitësi Antonio Cisternino, i shet blerësit Luca Correani, 50% (PESEDHJETE PERQIND) te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Shitja e kuotave të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie, në masën 50%, nga ana e ortakut Antonio Cisternino, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së tij mbi këto kuota si pasojë e këtij trasanksioni shitje.

Nga ana tjetër blerësi Luca Correani, është plotësisht dakort që të blejë këto kuota në masën 50%, kundrejt çmimit të përcaktuar më poshtë.

ÇMIMI I SHITJES: **5 000 lekë (pesemije).**

Palët deklarojnë se nga ana e Blerësit është likuiduar vlera monetare e sipërcituar prej 5 000 (PESEMIJE) LEKE, e cila përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, për të cilën palët kanë rënë dakord.

Kjo vleftë i është paguar shitesit, para redaktimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës së Noterisë kesh në dorë, pa asnje lloj pretendimi nga palët.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ortakë të shoqërisë "FRA&SERE Manifatture" shpk do të jenë:

1- ANTONIO CISTERNINO, me 50 % të kuotave të kapitalit (OSE 1 KUOTE),
**2-** LUCA CORREANI, me 50 % të kuotave të kapitalit (OSE NJE KUOTE)

**MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE:**

Me nënshkrimin e këtij akti, shitësi Antonio Cisternino, humbet pronësinë e tij në masen 50% ne kuotat e kapitalit të shoqërisë, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shitura, ndërsa blerësi Luca Correani njihet pronar i ligjshem i këtyre kuotave.

*Palët bien dakort që të gjitha të drejtat dhe detyrimet e derisotme që shoqëria "FRA&SERE MANIFATTURE" shpk, ka ndaj shtetit, bankave, subjekteve fizike/ juridike, ose të tretëve, cilatdo qofshin ato,* ***do të përgjigjet shoqëria "FRA&SERE MANIFATTURE" shpk dhe dy ortakët :ANTONIO CISTERNINO dhe LUCA CORREANI, sipas pjesës që i përket secilit në kapitalin e shoqërisë.***

Për shitjen e kuotave të kapitalit në pronësi të Antonio Cisternino, jep pëlqimin edhe bashkëshortja e tij, shtetasja italiane PAOLA LUBELLO, e datelindjes 14/08/1967, lindur ne Nardo (Le) Itali, identifikuar me karten e identitetit nr. AT2742473.

**ANEKSET E KONTRATËS**

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;

- Vendimi i Ortakut te vetem date 27/07/2020,
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "Fra&Sere Manifatture" Sh.p.k..
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Për sa më sipër do të bëhen ndryshimet përkatëse në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit të Bizneseve.

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; iu perkthye ne italisht prej perkthyeses se gjuhes italiane Arbana Zarka, njohur prej meje noteres, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**P A L Ë T**

**PALA SHITËSE**
**ANTONIO CISTERNINO**

ANTONIO CISTERNINO

**PALA BLERËSE**
**LUCA CORREANI**

LUCA CORREANI

**Jep pëlqimin bashkëshortja**
**PAOLA LUBELLO**

PAOLA LUBELLO

**NOTERE/ARJANA E. DODI/**

Autorizuar nga Ministria e Drejtësisë
PERKTHYESE ZYRTARE
ARBANA ZARKA
TRADUTTRICE GIURATA
Accreditata al Ministero di Giustizia

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SH.P.K. "FRA&SERE MANIFATTURE"**
Nr. 17 prot.

# V E N D I M

**Dateë 27/07/2020**

**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "FRA&SERE MANIFATTURE" shpk**

I marre ne Fier sot me daten 27/07/2020 ne seline e shoqerise **"FRA&SERE MANIFATTURE" shpk**, nga Ortaku i vetem ANTONIO CISTERNINO.

Duke pare ecurine e derisotme te veprimtarise se shoqerise,

**U KONSTATUA :**

Se shoqëria "FRA&SERE MANIFATTURE" shpk, me status aktiv, me qendër në Fier lagje "Bishanake, rruga "Skenderbeu" pallati nr. 2, kt 2, ap. 15, është rregjistruar në rregjistrin tregtar të shoqërive tregtare si person juridik, me numër **NIPT L83130401D**, me objekt veprimtarie : *"Prodhim konfeksionesh, punime artizanale, qendisje me makine dhe me dore, hekurosje, paketim. Fason Import-Eksport te artikujve si makina per qepje, makina per qendisje, hekurosje etj. Import- Eksport te perkohshem dhe difinitiv te lendeve te para dhe lendeve ndihmese. Realizim dhe furnizim te sherbimeve teknike ne fushen e prodhimit te veshjeve"*, me ortak te vetem ANTONIO CISTERNINO, i cili ka ne pronesi 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Duke vleresuar ecurine e derisotme te shoqerise , bazuar ne ligjin Per shoqerite tregtare dhe statutin e shoqerise dhe duke pare kerkesat dhe interesat personale, ortaku Antonio Cisternino, kerkon te shese 50% te kuotave te kapitalit bleresit Luca CORREANI, trasaksion qe do te kryhet me akt noterial.

Ne perfundim, Ortaku i vetem,

**V E N D O S I :**

1-Miratimin per kalimin e nje pjese te kuotave te kapitalit te shoqerise "FRA & SERRE MANIFATTURE" shpk, ne masen 50 %, nepermjet shitblerjes nga shitesi ANTONIO CISTERNINO, tek bleresi LUCA CORREANI.

2- Caktimin e z. ANTONIO CISTERNINO, ne detyren e administratorit te shoqerise per nje periudhe pese vjecare me te drejte rizgjedhje.

3-Te ngarkohet punonjesi i Shoqerise z. VALERIO KODHELAJ per te kryer ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregetar prane Qendres se rregjistrimit te bizneseve.

**ORTAKU I VETEM**
**ANTONIO CISTERNINO**

• FRA & Sere Manifatture •
Shpk
Nipt : L83130401D
FIER-ALBANIA

ANTONIO CISTERNINO

REPUBBLICA DI ALBANIA
Sh.p.k. "FRA & SERE MANIFATTURE"
Nr. 17 prot.

**DECISIONE**
Data 27/07/2020
**IL SOCIO UNICO DELLA SOCIETA' DI "FRA & SERE MANIFATTURE" SHPK**

Decide oggi a Fier il 27/07/2020 presso la sede della società "FRA & SERE MANIFATTURE" shpk, dall'unico Socio Antonio Cisternino.
Guardando lo stato attuale dell'attività della società,

COSTATA:

Che la società "FRA & SERE MANIFATTURE" SHPK, con status attivo, con sede nel quartiere Fier "Bishanake" strada "Skenderbeu" edificio n. 2, kt 2, ap. 15, è iscritta al Registro delle Imprese come entità legale, numero NIPT L83130401D, con l'oggetto dell'attività: "Fabbricazione di prodotti, artigianato, ricamo a macchina e mano, stiratura, imballaggio. Fason Import-Export di oggetti come macchine da cucire, macchine da ricamo, stiratura ecc. Importazione - Esportazione temporanea e differenziale di materie prime e materiali ausiliari. Realizzazione e fornitura di servizi tecnici nel campo della produzione di abbigliamento ", con il socio unico ANTONIO CISTERNINO, che detiene il 100% della quota di capitale dell'azienda.
Valutando la performance attuale della società, sulla base del diritto societario e dello statuto della società e esaminando i reclami e gli interessi personali, il partner Antonio Cisternino cerca di vendere il 50% della quota azionaria all'acquirente Luca CORREANI, un'operazione da effettuare e autenticata da atto notarile.
In conclusione l'unico Socio,

A DECISO:

1- Approvazione per il trasferimento di parte delle quote di capitale della società "FRA & SERRE MANIFATTURE" shpk, al 50%, attraverso la vendita da parte del venditore ANTONIO CISTERNINO, all'acquirente LUCA CORREANI.
2- Nomina di SIG. ANTONIO CISTERNINO, nella posizione di amministratore della società per un periodo di cinque anni con il diritto di essere rieletto.
3-Per delegare il Sig. Valerio Kodhelaj di apportare le modifiche pertinenti al Registro di commercio presso il Centro di registrazione delle imprese.

SOCIO UNICO
ANTONIO CISTERNINO

• FRA & Sere Manifatture •
Shpk
Nipt : L83130401D
FIER-ALBANIA

ANTONIO CISTERNINO

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2020072313852882 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 23.07.2020 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 1:08:52PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-060-1074 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

FRA & SERE MANIFATTURE SH.P.K.

Elda Kamani

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA